

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Projekti:

**"TRAJTIMI DHE MAGAZINIMI I PESHQVE
TE NGORDHUR"
(Aktivitet ekzistues)**

Vendodhja: Rruga "Dardania", Fshati Katund i
Ri, Njesia Administrative Kashar, Bashkia Tirane,
Qarku Tirane.

Subjekti zhvillues: "SEA FISH sh.p.k

Hartoi raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k
(Çert. Nr. 551 Prot, dt. 24.10.2008)

Administrator
Elidiana Shehu

Nentor, 2020

Pershkrimi i aktivitetit

Te pergjithshme

Aktiviteti ne vleresim konsiston ne proceset e perpunimit, pastrimit, konservimit dhe paketimit te produkteve te detit si (Acuke, karkaleca, midhje, sepie, kallamare, surim, levrek, koce) per prodhimin e konservave nga lendet e para te prodhimeve te detit te ngrira. Aktiviteti ne vleresim kryesisht punon si "Perpunim aktiv", duke nenkuptuar blerjen e produktit kryesisht nga vende te tjera si: Itali, Greqi, Kroaci dhe nje pjese te tyre ne Shqiperi. Me pas perpunimin e konservimin dhe shitjen e tij kryesisht ne tregun e huaj dhe nje pakice ne tregun vendas.

Persa i perket mbetjeve organike te ketij aktiviteti, eshte lidhur kontrate me subjekt te licensuar per menaxhimin e tyre lidhur me perpunimin dhe riciklimin e tyre.

Qellimi i aktivitetit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte perpunimi dhe konservimi i prodhimeve te detit te ngrira.


Ne kete aktivitet punohet per perpunimin e prodhimin e produkteve te detit te konservuara, kryesisht per llogari te kompanive te huaja. Vetem nje pakice e produktit perfundimtare shitet ne tregun vendas.

Zhvillimi i ketij aktiviteti ne nje zone me studim te miratuar si zone industriale prane infrastruktures rrugore dhe inxhinierike ne afersi te zones, perben nje aspekt pozitiv per anen ekonomike e mjedisore. Subjekti investitor, nese zbaton kushtet mjedisore qe percakton kuadri ligjor, rekomandimet e ketij raporti dhe lejes mjedisore do te reduktoje ndikimet ne mjedisin e rajonit. Funkcionimi i ketij aktiviteti sjell ndikime positive ne ekonomine vendase, e si rrjedhoje duhet pranuar edhe kostoja mjedisore e ketij aktiviteti, gjithmone brenda normave te lejuara te shkarkimeve ne mjedis.


Vlen te permendet se ky object, eshte ndertuar vite me pare per te njejtin destinacion dhe eshte ndertuar infrastruktura e nevojshme per aktivitet perpunimi te peshkut dhe prodhimeve te detit ne pergjithesi.

Informacion mbi vendodhjen e projektit.

Kapanoni ne te cilin zhvillohet aktiviteti ndodhet ne Rrugen dytesore Tirane-Durres, Rr. Dardania, Fshati Katund i Ri, Njesia Administrative Kashar, Bashkia Tirane, Qarku Tirane. Zone ne te cilen jane perqendruar nje numer i madh aktivitetesh industriale, te karaktereve te ndryshme si prodhime, perpunime, tregtime etj.



Ortofoto e vendodhjes se aktivitetit



Pasuria 211/1/34 Siperfaqe truall 2504 m² nga ku 540 m² ndertese.

Nevoja per aktivite te tilla ne Shqiperi

Aktiviteti ne vleresim konsiston ne proceset e perpunimit, pastrimit, konservimit dhe paketimit te produkteve te detit per prodhimin e konservave nga lendet e para te prodhimeve te detit te ngrira. Aktiviteti kryesisht punon si "Perpunim aktiv", duke nenkuptuar blerjen e produktit kryesisht nga vende te tjera si: Itali, Greqi, Kroaci dhe nje pjese te tyre ne Shqiperi. Me pas perpunimin e konservimit dhe shitjen e tij kryesisht ne tregun e huaj dhe nje pakice ne tregun vendas.

Lidhur me menaxhimin e mbetjeve organike te ketij aktiviteti, eshte lidhur kontrate me subjekt te licensuar per perpunimin dhe riciklimin e tyre.

Vendi yne eshte ende ne nje periudhe tranzicioni dhe karakterizohet nga nje ekonomi e dobet, duke u ndikuar ndjeshem nga prodhimi i ulet vendas (Prodhimi i Brendshem Bruto). Vendi yne eksporton nje numer te ulet produktesh me standarte dhe vlera per vende te zhvilluara si ne Bashkimin Europian ashtu edhe ne vendet e shteteve te bashkuara te Amerikes.

Keshtu nder produktet qe eksportohen jane: Minerali i Kromit, nafte bruto, prodhime bujqesore ndonese ne nivele teper te uleta, bime mjekesore te pa perpunuara dhe nje sere produktesh te tjera ne sasi te vogla. Nje nder kontribuesit kryesore ne buxhetin e vendit, jane aktivitetet fasone, ku nje sere ndermarrjesh te ndryshme, kryejne procesin e perpunimit te pjesshem ose te plote te produktit per tu pakeluar ose tregtuar ne vende te tjera te zhvilluara. Ne kete kuader mbizoterojne aktivitetet e prodhimit te konfeksioneve, kepuceve, ushqimeve te konservuara dhe pjese integrale te ndonje procesi prodhimi ne vende te tjera.

Duke u bazuar ne faktin se ekonomia Shqiptare eshte e lidhur ngushtesisht me keto aktivite, te cilat gjenerojne te ardhura dhe kontribuojne ne rritjen e Prodhimit te Brendshem Bruto, keto aktivite vleresohen me rendesi per vendin dhe vitet e fundit kane pasur edhe perkrahjen e organeve shteterore te krijimit dhe nxitjes se politikave per terheqjen e investimeve te huaja ne vendin tone.

Subjekti kerkues

Subjekti "SEA FISH" Sh.p.k, eshte nje subjekt privat i regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) me Numer Identifikimi (NIPT): L01920001K dhe ka perfaqesues ligjor Z. Taulant Kalo.

Objekti i aktivitetit te ketij subjekti sipas regjistrimit ne QKR eshte:

Import, eksport, tregtim me shumice dhe pakice te peshkut te fresket si dhe te gjitha produkteve te tij. Prodhim, perpunim dhe ambalazhim peshku. Prodhim, perpunim dhe ambalazhim midhje.

Teknologjia e aplikuar

Fabrika e "SEA FISH" shpk do te prodhoje konserva te ketyre artikujve :

- Acuke e marinuar me uthull.
- fileto aguge ne vaj ulliri ne kuti alumini
- fileto aguge ne vaj ulliri ne vazo qelqi
- fileto aguge ne vaj ulliri ne kova
- sardele ne kripe ne kuti alumini
- sardele ne vaj ulliri ne kuti alumini me gramature
- Karkalec i Fresket
- Midhje me vaj
- Midhje e ngrire
- Miks Fritur
- Miks Fruta Deti
- Fileto Levreku

- Fileto Koce
- Peshq te tjere te detit te perpunuara dhe te ngrire.

Linjat e perpunimit te prodhimeve te detit perbehen nga makineri e pajisje te thjeshta te pershtatshme per industrine ushqimore, te prodhuara ne vendet e Bashkimit European sipas standartit CE. Makinerite do te vendosen sipas skemave teknologjike te vecanta te shoqeruara me tavolinat e punes. Vendosja e objekteve, sallave te makinerive, dhomave frigoriferike, instalimeve te tjera teknologjike dhe magazines se amballazheve jane paraqitur perkatesisht ne paraqitjet hartografike, planimetrite, ne skemat teknologjike dhe fotot e ndryshme.

Linjat do te instalohen ne 2 salla me lidhje funksionale te pershtatshme dhe me siperfaqe te konsiderueshme, te favorshme per teknologjine qe do te perdoret. Ambjenti eshte teper i pershtatshem pasi :

- ka siperfaqe dhe kubature te mjaftueshme,
- lejon levizshmeri normale,
- ka lartesi brenda normave qe lejon manovrushmeri te montim-cmontimit te makinerive,
- siguron ndricim te mjaftueshem i cili krijon kushte shume te mira pune.

Sallat kane hapësira te mjaftueshme per tu veteajrosur por, cdo salla ka sistemin e saj te ventilimit. Ndersa magazinat frigoriferike jane te medha dhe te mbyllura te cilat po rikonstruktohen duke zbatuar teknologjine e duhur te termoizolimit.

Per te siguruar mosnderprerjen e procesit teknologjik pasi humbjet ne raste te tilla do te ishin teper te medha, energjia eshte siguruar si nga linja normale e rrjetit ashtu edhe me gjenerator elektrik me motorr diezel.

Produktet e gatshme te ketyre linjave do te plotesojne kushtet e standartit shteteror per ushqimet dhe produktet e mish-peshkut te miratuar Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit Tirane. Sipas planimetrise se vendosjes se linjave dhe makinerive, pershkrimi I teknologjise ne menyre te permbledhur do te jete si me poshte :

- **Linjat e perpunimit te produkteve te detit**
- **Linja e larjes dhe e pastrimit te produkteve te detit**
- **Linja e perpunimit teknologjik te produkteve te detit te pastruara**
- **Linjat e filetimit te peshkut**
- **Salla e filetimit te acuges**
- **Linja e amballazhimit**

Zyrat

Per zyrat ka ambjente te bollshme . Ato jane te perqendruara ne hyrje te kapanonit, para se te futemi ne sallat ku realizohet procesi i punes. Ndersa zyrat e shoqerise jane ne katin e dyte te pjeses veriore te godines dhe tualetet

Magazinat

Magazinat frigoriferike jane planifikuar ne anen e djathte kur futemi per ne sallen ku realizohen proceset e produkteve te gatshme dhe te lendes se pare (prodhime deti).

Shkarkimet dhe mbetjet qe prodhohen

Nga aktiviteti i shoqerise "SEA FISH" shpk ne fabriken e konservave, mund te gjenerohen keto lloje mbetjesh :

a) Mbetje té ngurta :

- Mbetje te aktivitetit jetesor te punetoreve, mbetje te ndryshme (letra, plasmas, tekstil, qelq, pjese metalike dhe etj.) qe rezultojne nga proceset e prodhimit.
- Mbetje organike te peshkut. Keto mbetje té ngurta grumbullohen ne kazane ose konteinere te mbyllur dhe dhe do té largohen nepermjet subjekteve te licensuara per menaxhimin e tyre, referuar ligjit te integruar te mbetjeve .

b) Mbetje té lengta :

- ujra te perdorimit teknologjik, te larjes se peshkut, te larjes se eneve e pajisjeve teknologjike, te larjes dyshemese dhe ujra te aktivitetit jetesor te personelit.
- Gazet e djegies se gazit te lengshem ne kaldaje, te gazoilit nga gjeneratori me motorr diezel i cili vihet ne pune vetem ne rastet e mungeses se energjise ektrike te rrjetit te zones.

Shkarkimi i ujerave te perdorur

Ujerat qe gjeneron aktiviteti i konservimit te peshkut konsiderohen ujera te ndotur, te nje standarti qe nuk duhet te shkarkohen ne mjedisin ujqor ose tokesor te zones.

Nga ujerat e shplarjes se materialit te lendes se pare dhe procesit teknologjik ne pergjithesi, nese nuk trajtohen, mund te shkaktohet ndotje e tokes se mjedisit te zones.

Ujerat e ndotur te gjeneruara nga aktiviteti duhet ti nenshtrohen nje trajtimi efektiv ne baze te cilesise se ujrave te gjeneruar.